



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

FTESË PËR KONSULTIM PUBLIK

Të nderuar Zonja dhe Zoterinj,

Republika e Shqipërisë po planifikon të ndërtojë seksionin e autostradës Adriatiko-Jonian: Murriqan - Lezhë me asistencën e BERZH dhe BE-së. Për këtë qëllim është përgatitur një dokumentacion i plotë për “WB30-ALB-TRA-01 Korridori Mesdhetar: Seksioni Rrugor Murriqan–Lezhë – Projektimi i Detajuar, Përditësimi i ESIA-s dhe Dokumentet e Tenderit”.

Palët e interesuara dhe anëtarët e publikut ftohen të marrin pjesë në takimet e konsultimit publik për Raportin e Përcaktimit të Fushëveprimit Mjedisor dhe Social (ESSR), të përgatitur për Projektin e planifikuar të Autostradës Murriqan–Lezhë.

Takimet e konsultimit publik do të zhvillohet si më poshtë:

Bashkia Shkodër:

Ditën e Hënë, datë 12 Tetor 2026; ora: 11⁰⁰AM; në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak,

Bashkia Vau i Dejës:

Ditën e Martë, 13 Tetor 2026; ora: 10⁰⁰AM; në ambjentet e Bashkisë

Bashkia Lezhë:

Ditën e Mërkurë, 13 Tetor 2026; ora: 14⁰⁰PM; në ambjentet e Bashkisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,

Ditën e Enjte, 14 Tetor 2026; ora 12⁰⁰ AM në ambientet e Godinës Portokalli, Salla e Mbledhjeve, kati i parë;

Takimet janë pjesë e procesit të angazhimit të publikut dhe palëve të interesuara në fazën e hershme të Projektit dhe synojnë të ofrojnë informacion mbi Projektin e propozuar, të paraqesin çështjet kryesore mjedisore dhe sociale të identifikuar deri më tani, si dhe të shpjegojnë qasjen që do të ndiqet gjatë vlerësimit të ardhshëm mjedisor dhe social.

Gjatë takimeve, ekipi i Projektit do të paraqesë një përmbledhje të autostradës së propozuar, ndjeshmëritë fillestare mjedisore dhe sociale të identifikuara përgjatë gjurmës së propozuar, si dhe metodologjinë që do të zbatohet gjatë Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS/ESIA) që do të përgatitet në vijim.

Pjesëmarrësit do të njihen gjithashtu me Planin e Angazhimit të Palëve të Interesuara (SEP), i cili përshkruan mënyrën se si do të publikohet dhe ndahet informacioni mbi Projektin, mënyrën se si do të angazhohen palët e interesuara, si dhe mënyrën se si do të mblidhen dhe trajtohen komentet dhe sugjerimet gjatë gjithë procesit të përgatitjes së Projektit.

Çdo takim do të përfshijë një prezantim të Projektit, të ESSR-së dhe SEP-it, i ndjekur nga një sesion i hapur pyetje-përgjigje (Q&A), si dhe mundësinë që pjesëmarrësit të paraqesin komentet e tyre.

Periudha e konsultimit publik dhe e paraqitjes së komenteve do të zgjasë nga data 28 shtator 2026 deri më 28 tetor 2026.

Të gjitha palët e interesuara dhe anëtarët e publikut ftohen të shqyrtojnë dokumentet e publikuara dhe të paraqesin komentet dhe sugjerimet e tyre duke përdorur të dhënat e mëposhtme të kontaktit:

kristian.shkreli@vaudejes.gov.al;

elvis.preci@vaudejes.gov.al;

info@vaudejes.gov.al;

flamurkuci@gmail.com;

fatjon_zefi@yahoo.com;

info@lezha.gov.al;

planifikimiterritorit@bashkiashkoder.gov.al;

elfiori.zotaj@arrsh.gov.al;

Kopjen elektronike të prezantimit të projektit mund ta gjeni në adresën:

[alhttps://www.arrsh.gov.al/](https://www.arrsh.gov.al/)

Për çdo informacion shtesë ose sqarime të mëtejshme kontaktoni:

Email: info@arrsh.gov.al